



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 30 shtator 2020, në mbledhjen e XXXVI (tridhjetë e gjashtë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në ish ndërtesën e Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës dhe në të njëjtën kohë në cilësinë e ushtruesit të detyrave dhe kompetencave të Kryetarit të Komunës (*shkresa e MAPL-së me nr.prot.02-128/2 e datës 06.02.2020*) Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Podujevës, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësuesi i OJQ-së SDK, si dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë e cila gjithashtu po mbahet në kushte dhe masa jo të zakonshme për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Shtoi, konsideroj se thirrjen dhe materialet i keni marrë me kohë, po ashtu edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur një ditë më parë, andaj mund të fillojmë me punë.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit të kësaj mbledhje

1. Propozim Vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore 2022-2023

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, marrë për bazë Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Qarkoret buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave si dhe në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023 të Komunës së Podujevës është paraqitur para Kuvendit projektbuxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2021 si dhe projeksionet për vitet 2022/2023. Pas miratimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021/2023 më datë 10.08.2020 nga Komuna e Podujevës, Ministria e Financave ka lëshuar Qarkoren Buxhetore 2021/02 e cila edhe është marrë për bazë nga Komuna e Podujevës për përgatitjen e projekt buxhetit 2021/2023.

Më datë 28.08.2020 kemi pranuar një shkresë nga Ministria e Financave sipas të cilës sqarohet se si shkak i pandemisë ka rënie të të hyrave për vitin 2020 dhe sipas parashikimeve makroekonomike edhe në vitet 2022/2023, andaj është parë e arsyeshme të rishikohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2022/2023 dhe si rezultat i kësaj është kërkuar nga Komunitat që të mos procedohet me

dërgimin e propozim buxheteve komunale derisa nga Ministria e Financave të mos pranohet Qarkorja Buxhetore 2021/03, dokument ky i cili më 14.09.2020 është lëshuar nga Ministria e Financave me të cilën janë përcaktuar kufijtë final të buxhetit për vitin 2021 dhe projeksionet për vitet 2022/2023 dhe përfundimisht buxhetit i Komunës së Podujevës për vitit 2021 është 23,853,654.00€ dhe atë sipas strukturës sipas materialit përkatës të cilin e keni paravetës, *(në detaje drejtori i informoj për shumat buxhetore të ndara në kategori dhe programe të caktuara buxhetore si dhe shumat e shpërndara sipas instruksioneve të Ministrisë së Financave nëpër kategori dhe programe buxhetore).*

I gjithë ky propozim buxhet mund të ndahet në dy pjesë, 1-shpenzime operative në shumën prej 16,253,628.00€ dhe 2-shpenzime kapitale në shumën prej 7,600,026.00€, ku shuma më e madhe buxhetore është e destinuar në kategorinë e pagave dhe për investime kapitale, ndërsa në kategorinë e subvencioneve kemi paraparë maksimumin e buxhetit të lejuar të cilin pastaj e kemi shpërndarë në Drejtori dhe sektorë të caktuar.

Të nderuar, materiali përkatës ju është dërguar të gjithëve me kohë duke përfshirë edhe listën e projekteve të planifikuara për vitin 2021 dhe prioriteteve për vitet 2022/2023, ku është përfshirë një shtrirje të gjerë territoriale e Komunës duke u munduar t'i plotësojmë sa më shumë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, por duke pasë parasysh se gjithnjë nevojat dhe kërkesat e tyre janë më të mëdha se sa mundësitë buxhetore por që jemi munduar të bëjmë më të mirën e mundshme dhe konsiderojmë se kemi paraqitur një propozim të arsyeshëm dhe që përfshinë gjitha fushat investive dhe më gjerë.

Pas dërgimit të materialit, jemi konsultuar edhe njëherë me Ministrinë e Financave nga e cila është kërkuar që propozim vendimi të ri rregullohet teknikisht, dhe atë te burimet e financimit, përkatësisht paragrafit 1 i shtohet edhe një nënparagraf, dhe atë; klauzola e investimeve kalon si e veçantë në nënparagrafin 1.2, kurse të hyrat vetanake kalojnë në nënparagrafin 1.3 të këtij neni, kurse shumat buxhetore mbeten të njëjta.

Siç edhe jeni në dijeni projektbuxheti i Komunës është një prej dokumenteve më të rëndësishme që miratohet nga Kuvendi i Komunës, prandaj kërkoj nga Ju që ta shqyrtoni dhe miratoni këtë propozim projektbuxhet të Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe prioritetet për vitet 2022/2023.

z.Hasan Ajeti, theksoi, pa dyshim se ky vit është një ndër vitet më sfidues i qeverisjes lokale të Podujevës dhe para nesh vie me sfida të panjohura për shkak të pandemisë Covid-19 dh ne duhet të jemi objektiv sa i përket vështirësive që kemi sot si Komunë e pa dyshim edhe për të ardhmen.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e bëri një prezantim të qartë lidhur me buxhetin e Komunës për vitit 2021 dhe parashikimet buxhetore dy vitet pasuese, buxhet i cili është përgatitur duke u mbështetur në kornizat e legjislacionit në fuqi. Sigurisht që kërkesat dhe nevojat janë më të mëdha n'raport me mundësitë buxhetore, por ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-ës mendojmë se duhet mbështetet ky propozim vendim pasi që brenda hapësirës buxhetore, sektorët/dikasteret e Komunës do të realizojnë projektet e parapara dhe pa dyshim që ato do të kenë inpakt direkt dhe indirekt në të mirë dhe në shërbim të qytetarëve të Komunës së Podujevës.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, buxheti si një prej dokumenteve më të rëndësishme për këtë vit, para asamblesë komunale paraqitet nga një Ekzekutiv i pazgjedhur nga votat e qytetarëve që mbahet në këtë karrige të uzurpuar nga kapësit e shtetit që duke mos i mbajtur zgjedhjet komunale i kanë nxjerrë jashtë funksionimit ligjor institucionet e vendit.

Ky buxhet është në vazhden e kësaj logjike qeverisëse të papërgjegjshme që për afër 4 vite apo më mirë të themi që nga paslufta nuk arrinë të bëjë politika prioritare zhvillimore për Komunën tonë.

Buxheti për këtë vit është i ndërtuar dobët ne çdo aspekt të tij, e për më keq, është hartuar një projektbuxhet duke mos përfillur procedurat e planifikimit e duke mos u konsultuar fare me

qytetarët, gjë që implikon drejtpërsëdrejti shkeljen e procedurave ligjore për transparencë dhe llogaridhënie, mirëpo është e qartë se ky është një buxhet elektoral dhe një buxhet dëshirash.

Nuk keni pasur guxim për ballafaqim me qytetarët sepse ka shumë projekte të cilat nuk mund të realizohen brenda një viti e kjo bëhet për të mashtruar qytetarët për projekte. Jo kot nuk i specifikoni rrugët nëpër fshatra e qytet, sepse një gjë e tillë është shumë relative kur vije puna tek vota, aty pastaj vendosni se cilat lagje t'i privilegjoni me asfalt e pastaj t'i shantazhoni për votë.

Ne si Lëvizje Vetëvendosje, edhe për buxhetet e viteve të kaluara i kemi dhënë vërejtjet tona, qoftë për nivelin e dobët profesional apo në prioritetet se ku po drejtohen investimet publike, mirëpo fatkeqësisht ky pushtet i paligjshëm, abuziv por edhe i padijshëm nuk i ka marrë parasysh, prandaj edhe neve si subjekt po na detyrohet t'i përsërisim vërejtjet, por jo për fajin tonë.

Buxheti si dokument paraqet procesin përmes të cilit sigurohet financimi i projekteve prioritare zhvillimore të identifikuar në strategjitë zhvillimore lokale, e që disa dokumente Komuna nuk i posedon fare, siç është; plani zhvillimor urban që është crucial për zhvillimin normal të qytetit e të Komunës, dokument pa të cilin nuk e di se si vendosë Komuna për projektet infrastrukturore kur dihet se çdo projekt, çdo ndërtim, qoftë investim privat qoftë publik duhet të jetë në përputhje me këtë dokument zhvillimor e që kjo qeverisje kuturu asnjëherë që nga paslufta nuk e ka përpiluar një plan zhvillimor urban. Edhe dokumentet të cilat i ka përpiluar dhe aprovuar vetë ky pushtet nuk i ka lidhur në mënyrë të duhur në buxhet, në mënyrë që projektet e identifikuar në strategjitë zhvillimore t'i inkuadrojë në procesin buxhetor.

Ky pushtet vazhdon me logjikën e gabuar ku pjesën dërmuese të investimeve i orienton në asfalt, në rrugë të ndërtuar pa plan, pa analizë fizibiliteti dhe të punuara dobët, madje në vitin 2021 ende flitet për meremetimin e rrugëve me zhavorr. Pastaj të hyrat vetanake janë shumë të ulëta, që do të thotë paaftësi ose keq menaxhim, nuk ka sqarim se ku ndahen subvencionet nëpër Drejtori të caktuara, në subvencionimet për shëndetësi, cilat sëmundje. Subvencionet në kulturë, rini dhe sport; a do të subvencionohet kultura, rinia apo sporti, sepse një shumë prej 40,000 vështirë se i mbulon tri fushat. Nuk keni parashikuar subvencione për ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Shumën prej 25,000.00€ për kanalizim ndoshta është mirë drejtori të sqarojë se çka do të bëjë me atë shumë, nëse veç mundet të bëjë diçka me këtë shumë sepse me një planifikim të tillë lëni përshtypje se Podujevën po e llogaritni si një fshat të vogël. Mandej Buxhetimin gjinor e keni bërë sa për sy e faqe me vetëm një total të përgjithshëm, pa e specifikuar për Drejtori të caktuara. Në vitin 2021 është paragjykuar numri i përfituesëve dhe gjinia, nuk ka rregullore që e përcakton se duhet të fitojnë vetëm gratë ose sa burrat, prandaj nuk mund të paragjykoni.

Lëvizja Vetëvendosje propozon që në këtë buxhet të inkuadrohen projekte që e mbështesin zhvillimin e fushave proiritare për Komunën tonë, si: ekonominë dhe bujqësinë, arsimin, shëndetësinë, kulturën, rininë e sportin.

-Ndarje e 500,000.00€ për ndërtimin e zonës ekonomike

-Çdo vit të ndahen nga 500,000.00€ për subvencionimin e bizneseve prodhuese dhe të subvencionohen 10% e makinerive të blera me qellim të instalimit të linjave të reja prodhuese.

-Të ndahen 500,000.00€ për renovimin e shkollave

-Të ndahen 1 milion euro për ndërtimin e shtëpisë së kulturës

-Të ndahen 100,000.00€ për funksionalizimin e mjekësisë së patronazhit.

z.Bashkim Sylja, theksoi, sot po diskutojmë për projektbuxhetin i cili pikë së pari në mënyrë teknike është jo mirë i detajuar dhe nuk i ka kaluar fazat e dëgjimit publik e që ne të gjithë jemi në dijeni se jemi në kohë pandemie por që Komuna po e shfrytëzon në mënyrën ashtu siç po i konvenon kjo situatë pandemie.

Sikurse vitet e kaluara prioritet i kësaj qeverisje ka qenë urbanizmi dhe infrastrukturë publike duke lënë anash investimet në arsim dhe shëndetësi. Në këtë projektbuxhet në urbanizëm dhe Infrastrukturë janë planifikuar investimi mbi 5 milion euro, kurse në arsim 232,026.00€ dhe shëndetësi 566,930.00€. Ky projektbuxhet nuk është ndërtuar mbi bazën e planifikimit dhe Strategjisë së zhvillimit e cila është miratuar në këtë Kuvend vitin e kaluar.

Te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit nuk janë të paraqitura projektet mirë me detaje. Ndërtimi i trotuareve, ndriçimi publik, ndërtimi i urave janë përfshirë me dhjetëra fshatra si dhe shuma që do të investohet në total, mirëpo pa u specifikuar se në cilin fshat ose vendbanim do të investohet, ose edhe shuma për cilin projekt po rrugë.

Te shëndetësia janë planifikuar 316,000.00€ për blerjen e pajisjeve mjekësore për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare - QKMF, mirëpo është mirë të marrim një informacion nga drejtori përkatës se për çfarë pajisjesh bëhet fjalë pasi që në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal janë planifikuar të investohen në: 31 shërbime në QKMF, 27 shërbime në Qendrat e Mjekësisë Familjare-QMF dhe 6 shërbime në Ambulant e Mjekësisë Familjare-AMF, shërbime të cilat do fillojnë punën/shërbimet nga 01 janari 2022, ndërsa në projektbuxhetin e Komunës për vitin 2021 nuk është paraparë për investim as për QMF as në AMF-të. Te Bujqësia janë paraparë 76,350.00€ subvencionimin për fermerët e dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore, andaj shtroj pyetje a fjala është për ngritje të një fondi që drejtori përkatës e ka cek në seancën e jashtëzakonshme, apo ky fond do të mund të subvenciononte fermerët që janë dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore edhe në këtë vit.

Ky projektbuxhet nuk duhet të shihet krejt zi sepse ka edhe projekte shumë të nevojshme për qytetarët dhe për këtë arsye në Grupi i këshilltarëve të PDK-së nuk do të jemi kundër por do të abstenojmë.

z.Adnan Zymeri, theksoi, nëse për projektbuxhetin do të bisedonim vetëm në si këshilltarë të Kuvendit atëherë ky do të ishte një dokument i cili do të tregonte se çfarë ka planifikuar Ekzekutivi i Komunës për vitin 2021 dhe atë se çfarë do të duhej të planifikonte sipas opozitës, mirëpo rolet e secilës palë në çdo 4 vite fatmirësisht i përcakton rezultati, për të vazhduar edhe më tej meqë ky dokument ka rëndësi përtej diskutimit tonë vlen të theksohet se projektbuxheti paraqet votën tonë më të rëndësishme i cili në aspektin teknik dhe përmbajtësor është tërësia e projekteve që ka planifikuar t'i realizoj ekzekutivi i komunës, ndërsa në aspektin politik është përmbushja e premtimeve të kontratës së nënshkruar me qytetarin në zgjedhjet e fundit.

Në buxhet tregohen orientimet dhe pasqyrohen kërkesat prioritare të vitit fiskal në secilën fushë duke filluar nga urbanizmi që përfaqëson përqindjen më të madhe të investimeve kapitale marrë parasysh shtrirjen gjeografike të komunës tonë dhe kërkesat e shumta dhe të përditshme për asfaltim të rrugëve e që me të drejtë opozita mund të pyes përse nuk ka përfshirje të disa fshatrave në projektet e vitit 2021, e përgjigja është shumë e thjeshtë sepse në shumicën prej atyre fshatrave infrastruktura do të kryhet këtë vit. Për qytetin, menaxhimi i hyrjeve dhe objekteve banesore si dhe vazhdimi i sheshit të qytetit në këndvështrimin tim janë projektet më të rëndësishme, por që nga këtu kërkoj që në qytet të intervenohet edhe një pjesëz rruge pas kompleksit të banesave “Malësia”, kërkesë kjo e qytetarëve të cilët e shfrytëzojnë atë rrugë prej se kanë filluar punimet në shesh.

Sa i përket sheshit të shumë kritikuar, super-selfie po na dalin qoftë pushtetit qoftë opozitës ende pa përfunduar, imagjinojeni kur të përfundon.

Rritja e sigurisë për qytetarët duke shtrirë rrjetin e ndriçimit publik nëpër rrugë dhe trotuare janë projekte të cilat duhet përshëndetur e që për këtë në emër të banorëve të fshatit Bajçinë dhe banorëve të qytetit që kanë vlerësime të larta dua të falënderoj drejtorin e Drejtorisë përkatëse për shtrirjen e ndriçimit publik, me theks në hyrje të rrugëve të qytetit, mbështetje kjo e cila bëhet e obligueshme kur shoh se projekte të tilla do të vazhdojnë edhe në vitin 2021.

Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me projektet mbështetëse në bletari, blegtori dhe pemëtari do të përmbush fjalën e saj para fermerëve Llapjan, këtë herë edhe duke planifikuar mbështetjen e fermerëve të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Jam i lumtur të shohë që Klubit të Handbollit “Llapi” dhe Klubeve të tjera Llapjane, me renovimin e palestrës “Hakif Zejnullahu” do t’iu sigurohen kushte më të favorshme për zhvillimin e garave sportive, prandaj nga Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që vijnë nga Llapi do të kërkojmë shtytje të projektit të ndërtimit të palestrës së re të qytetit.

Përmirësimi i infrastrukturës së jashtme dhe të brendshme të shkollave dhe pajisja me kabinete është projekt shumë i rëndësishëm në arsim po aq sa do të ishte i arsyeshëm një studim arsyeshmërie për ndërtimin apo jo të objekteve të reja shkollore, studim i cili do të mundësonte rishikimin e politikave të regjistrimit të nxënësve marrë para sysh lëvizjet dhe migrimin e popullsisë, dhe një pasqyrë e tillë mbi gjendjen do të decentralizonte shkollat fillore në qytet që kanë nevojë për hapësira të reja sikurse kërkesa e shkollës fillore “Naim Frashëri” për hapësira të reja, klasë të reja dhe një sallë sportive që është kërkesë shumë e arsyeshme bazuar në numrin prej 1100 të nxënësve që ka kjo shkollë. Duke rikujtuar kompetencat e nivelit lokal në zhvillim ekonomik si dhe dokumentet rreth zhvillimit ekonomik të miratuara nga ky Kuvend, për mua është më e arsyeshme orientimi i shumës së dedikuar për infrastrukturën publike të zonës ekonomike në themelimin e një inkubatori të bizneseve sepse pengesat ligjore dhe pronësore frikësohem se do ta bëjnë të mundshëm realizimin e këtij projekti të paraparë.

Energjia e drejtorit të ri, e kombinuar me gatishmërinë për bashkëpunim besoj se do të sjellë projekte të përbashkëta me donatorë, projekte për të cilat drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit Ekonomik ka paraparë një shumë prej 70,000.00€.

Në ekonomi, efektet e krizave japin impakt në periudhat pasuese, prandaj kam bindjen e argumentuar se shpërndarja e mjeteve në formën e subvencioneve duhet t’i nënshtrohet një rishikimi korrekt duke realizuar mbështetje për kërkesat e kamotshme të ofrimit të praktikave me pagesë për studentë dhe po ashtu duke orientuar mjete edhe në projekte të cilat do të implementoheshin nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Në kohë pandemie, projektbuxheti i Komunës është sikurse projekt Ligji për rimëkëmbje i Qeverisë, prandaj ju ftoj ta japim shembullin e mirë të bashkëpunimit në nivel lokal dhe ta votojmë këtë propozim buxhet.

z.Pajtim Balaj, theksoi, projektbuxheti 2021dhe parashikimet 2022/2023 ngjashëm me Kornizën Afatmesme Buxhetore, në gjykimin tim duket sipërfaqësor, i padetajuar, nuk ka planifikime të qarta dhe ka një qasje shkel e shko në planifikim. Nuk ka objektiva të bazuara në dokumente zhvillimore, nëse i shihni detajet nga Strategjia për zhvillim sigurisht që shihni se ka shmangie nga ajo. Planifikimi paraqitet në vija të kodeve bazike por pa detaje të planifikimit dhe kjo është shembulli që e mori edhe kolegja parafolëse znj.Lirika Maliqi rreth asfaltit i cili përmendet vetëm ashtu pa u specifikuar se ku janë ato rrugë. Lista e projekteve kapitale paraqitet me shumë paqartësi sikurse çdo pikë tjetër, Komuna ka rritje të investimeve kapitale por kjo nuk reflekton në rritjen e buxhetit për mirëmbajtje, pastaj në sferën e investimeve për infrastrukturë dhe zhvillim ekonomik shumat e planifikuara janë minimale. Përgjithësisht priorizimi i punëve dhe investimeve sikur çdo herë bëhet në funksion elektorale në funksion të punëve që potencialisht sjellin vota apo eventualisht i ruajnë votat ekzistuese të partisë.

Edhe diçka tjetër që është jashtë kësaj teme por që në një formë më ngacmoj parafolësi z.Adnan Zymeri në diskutimin e tij ka të bëjë me rezultatin çdo 4 vite, e që unë i them kolegut që nuk e keni komoditetin të flisni për zgjedhje kur ka 6 muaj që në mënyrë të paligjshme po e mbani Komunën të uzurpuar, pastaj pjesa tjetër që lidhet me sheshin e qytetit, urdhëroni dilni shiheni se në çdo rresht të

pllakave të shtruara gjeni pllaka të thyera dhe grisura, nuk di a keni ndonjë menaxher të projektit që i mbikëqyrë këto punë, por unë po të isha në vend të tij nuk do t'i pranoja.

znj.Mrika Thaqi, theksoi, sot paravetës kemi projektbuxhetin e Komunës për vitin 2021 dhe projeksionet për vitet 2022/2023, e që në një kohë të ngarkuar nga gjendja e përgjithshme si pasojë e pandemisë Covid-19, situatë dhe gjendje jo normale dhe si e tillë nuk ka se si të mos reflektoj edhe në hartimin e këtij projektbuxheti, propozim i cili do të duhej të ishte me një përmbushje sa më gjithëpërfshirëse e nevojave të qytetarëve të dala nga dëgjimet buxhetore apo debatet me qytetarë, kurse sa janë mbajtur me sukses këto debate lë shumë për të dëshiruar, shtoj kësaj edhe gjendjen e rënduar si rezultat i pandemisë.

Në këtë drejtim kam vërejtur projekte të ndriçimit publik pothuajse në të gjitha lokalitetet e Komunës e që mua më vie mirë që kemi arritur në këtë fazë dhe që janë përmbushur nevojat tjera, mirëpo do të ishte mirë dhe do të duhej kujdes i shtuar se sa është kostoja e mirëmbajtjes dhe sa do ta rëndoj buxhetin e Komunës për të mbajtur funksional këtë projekt.

Ajo që më bëri përshtypje është edhe ndarja e një pjese buxhetore për mbjelljen e drunjtëve dekorativ, shtoj këtu edhe vazhdimin e ndërtimit të sheshit të qytetit, pra drita po, drunjtë dekorativ po, shesh po, por uroj që edhe shkenca ta zbuloj medikamentin për Covid-19 dhe ne të mund të gëzojmë këto, mirëpo edhe përkundër vërejtjeve që i kemi, edhe përkundër faktit që mendojmë se ky projektbuxhet nuk është gjithëpërfshirës ne (*Grupi i këshilltarëve të AAK-së*) nuk do t'i themi jo, duke uruar që buxhetin tjetër, pa këtë gjendje të krijuar, ta mendojmë më mirë, të jemi më afër qytetarëve sepse fundja demokracia e zhvilluar nënkupton ofrimin e qytetarit me vendimarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe bashkërisht me neve që jemi këtu si demokraci përfaqësuese.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, më bënë përshtypje disa prej parafolësve ku disa e lavdëruan disa e kritikuan këtë propozim projektbuxhet të Komunës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore 2022/2023, e që mendoj se kur janë me vend është e natyrshme dhe duhet të jetë e pëlqyeshme.

Po nisem prej kolegut parafolës z.Adnan Zymeri të cilin e paralajmërova se do t'ia parashtroj disa pyetje por që tani nuk qenka prezent, sepse filloj ta lavdëroj këtë propozim projektbuxhet duke përfshirë edhe arsimin, shëndetësinë, bujqësinë dhe gjitha sektorët tjerë, i cili para rreth një muaji përmes facebook ka dhënë dorëheqje prej të gjitha strukturave të LDK-së kurse sot e lavdëroj, unë desha ta pyes atë si asamblistë dhe jam shumë i bindur se zotëri Zymeri si asamblistë i pozitës në këtë Kuvend – LDK-së por edhe shumë asamblistë tjerë të këtij subjekti por edhe gjithë asamblistët tjerë edhe të opozitës, asnjë prej tyre nuk e din për vendin prej nga vie se në cila rrugë do të asfaltohet apo do të ndriçohet ose ku do të rregullohet kanalizimi, pastaj pyetja për kolegun në fjalë shkon edhe për fshatin Bajçinë se në vitin 2021 cila rrugë do të asfaltohet e që jam shumë i sigurtë që nuk është në dijeni si asamblistë e që duhet ta dinte, pastaj shumë pak jam i interesuar të bëhet zgjidhje në arsim sikurse që është duke ndodhur me punë kryesin e shkollës në fshatin Dumnicë e cila është mbyllë para dy deteve dhe nuk e ka kryer punën kurse për një periudhë të gjatë shkollat nuk kanë qenë të hapura si shkak i pandemisë dhe pushimit verorë.

Është me rëndësi se ky dokument nuk ka kaluar nëpër dëgjime publike buxhetore e që si arsyeshmëri merret periudha e pandemisë por që e paarsyeshme ka qenë grumbullimi i shpërndarjes së koshereve të bletëve para një dite në sheshin e qytetit këtu afër, pastaj shumë më i madh ka qenë pjesëmarrja e personave të intervistuar dhe atyre të dëgjuesve të transparencës për intervistim për drejtorë të shkollave në këtë sallë, madje shumë më i madh është pjesëmarrja jonë kështu siç jemi tani në këtë sallë se sa organizimi i 3 ose 5 dëgjimeve publike buxhetore për këtë dokument.

Aspak nuk po i hynë në punë asnjë Drejtorie emërtimi i rrugëve në lokalitete të ndryshme, shembull unë nuk e kam vërejtur që as në vitin 2021 do të rregullohet rruga Bellopojë – Dyz e cila është e pakalueshme sikurse që ka edhe rrugë tjera të tilla, ndërsa kamë vërejtur shumë rrugë tjera në fshatra

të ndryshme që krijohet komoditet në disa fshatra si Metehi apo siç e potencoj kryetari i fshatit i zgjedhur politikë që në Shajkoc çdo rrugë dhe rrugicë është me ndriçim e që është në rregull kjo por duhet të krijohen mundësi të barabarta. Pastaj kam vërejtur se tek Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE e që a ka mundësi që drejtori i ri i kësaj Drejtorie si i zgjedhuri më i mirë nga subjekti në pushtet për ta drejtuar këtë sektor, ndarjen e buxhetit prej 30,000.00€ për ndërtimin e infrastrukturës në zonën publike ekonomike, a mundet drejtori të na tregoj se ku është ai vend/lokacion, apo drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ a mund të na tregoj se ku është ndarë kjo zonë sepse jemi të interesuar ta mbështesim edhe ne zhvillimin ekonomik edhe pse jemi opozitë, mirëpo nuk ka pronë e as vend të ndarë për këtë çështje, kurse një pronë që e ka ndarë drejtori i DPKGJ ka dalë pronë e huaj dhe në menaxhim të huaj e që është ndërprerë ai proces, andaj nuk mund ta mbështetim një dokument të tillë ashtu siç e ceku parafolësja znj.Mrika Thaqi për hir të demokracisë sepse për hire të demokracisë ndryshe punohet.

Pra nëse ka përgjigje dhe nëse është këtu prezent drejtori në fjalë është mirë të na tregoj se ku do të bëhet infrastruktura përkatëse, e që unë dyshoj se nuk e din as vet, e që nëse mundet të na tregoj vendin se ku do të bëhet zona ekonomike unë këtu publikisht e them se do ta ketë përkrahjen dhe votën time dhe do të insistoj edhe te Grupi i këshilltarëve të PDK-së që ta jap votën, madje as këshilltarët e LDK-ës nuk e dinë se ku do të bëhet ai investim.

Pyetje tjetër konkrete e kam për Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit – DKRS e cila ka planifikuar buxhet në shumë 50,000.00€ për ndërtimin e Bibliotekës, temë kjo e cila është ngritur vazhdimisht për rreth 3-4 muaj që nga mbyllja e ish Bibliotekës dhe ndërtimit të rrugës së re përgjatë lumit Llap apo nga Xhamia, dhe sot kemi një gjendje ku librat janë dërguar në disa shkolla dhe disa në bodrum, e që në bodrum kemi mbetur edhe ne këtu që jemi edhe pse është bërë investim i ri por që ende po mbajmë mbledhje në këtë sallë të mykut, andaj a ka mundësi që drejtoresha e DKRS-së të më tregoj se ku do ndërtohet objekti i Bibliotekës, e them këtë sepse fillimisht është thënë se ky objekt ku jemi do të bëhet bibliotekë, do të futen disa OJQ dhe Organizata të Luftës etj, kështu që këto parashikime buxhetore nuk mund të mbështeten kështu në këtë formë sepse vetë drejtoresha nuk e dinë se ku do ta ndërtoj këtë Bibliotekë, nëse e dinë duhet ta thotë këtu dhe ta tregoj ku është ajo parcelë dhe të kërkoj mbështetjen tonë.

Kështu që unë i parashtrova disa pyetje konkrete për të cilat kërkoj përgjigje nga kompetentët duke mos përjashtuar edhe ndonjë përgjigje eventuale nga Kryesuesi i Kuvendit sepse drejtorët e Drejtorive përkatëse nuk qenkan prezent këtu, Nënkryetari po ashtu nuk po vie në mbledhjet e Kuvendit prandaj nuk po dimë se si ta mbështesim këtë projektbuxhet sepse nuk po kemi përgjigje në pyetjet tona e të cilat ishin konkrete, jo politike apo nga cilësia e opozitës, përse nuk specifikohen rrugët të cilat planifikohen të asfaltohen, ku do të investohen mjetet buxhetore të ndara për zonën ekonomike konkretisht ku është ai lokacion, pastaj ku është lokacioni për ndërtimin e Bibliotekës.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, që sa vite e vite i njëjti orientim i buxhetit, asfalt dhe vetëm asfalt, çudi, sikurse ky vend i yni ti ketë të gjitha gjërat e nevojshme për qytetarët. Asnjëherë nuk menduat për diçka që është e rëndësishme, shembull, për arsim i cili në Komunën e Podujevës është tmerr, shkollat pa fotokopje, pa kabinete për lëndët profesionale, shkolla pa fusha sportive, pa salla të edukatës fizike, mandej shkollat e fshatrave Llugë dhe Dumnicë mbyllen për shkak të renovimit dhe gëlqerosjes sikurse nuk ju kanë mjaftuar 3 muaj i pushimit verorë, kurse shkollës së fshatit Pakashticë i mungon uji i pijes, nxemjet qendrore e si duket në mungesë të sallës së edukatës fizike nxënësit lëndën e edukatës fizike e mbajnë në shtëpi, e mos të flasim që asnjëherë nuk është planifikuar për shujtje për nxënës në mënyrë që nxënësit të ndihen të barabartë.

Pastaj mos realizmi i kërkesës tonë për ndërtimin e Çerdheje në fshatin Lluzhan dhe mos rregullimi i Çerdhes së vetme të Komunës tonë. Mandej në Kulturë asnjë investim për të rinjtë Llapjan në

mënyrë që kohën e lirë ta shprehin në talentin e tyre, pastaj në shëndetësi ndodh që në shekullin e XXI pastruesit e QKMF-së pastrojnë me Çebe e që mund ta merrni me mend se çfarë higjienë mbahet aty. Në një kod buxhetor është cekë, vazhdim i ndërtimit të parqeve dhe këndeve të lodrave për fëmijë, andaj pyes ku janë ato pjesë në mënyrë që t'i frekuentojmë edhe ne, mandej ku është stacioni për qenët endacak dhe a është funksional, kur do të kemi një strehimore për ata që kanë dhunë në familje, kur do të ketë një vend për të moshuarit që ta kalojnë një pjesë të kohës së lirë.

Pra ka edhe shumë e shumë gjëra të tjera që qytetarët tanë ndjejnë nevojën për të bërë një jetë më dinjitoze, por kot sepse ju sjellni të njëjtin shabllon për këtë buxhet.

z.Avni Fetahu, theksoi, propozim buxheti i sjellur këtu për votim do të duhej respektuar disa parime bazë elementare siç është transparenca që u përmend këtu me të drejtë e cila ka të bëjë me qasjen e qytetarëve në të gjitha fazat e buxhetimit duke filluar nga planifikimi deri te realizimi i tij, kurse sa është transparent ky lloj propozim buxhet tregon edhe vet fakti i reagimit të OJQ-ve nga planifikimi deri te realizimi i tij. Për kureshtjen e juaj, kur do të keni kohë zgjidhni cilëndo Komunë të Republikës së Kosovës dhe bëjeni krahasimin e propozim buxhetit me atë komunë dhe me Komunën tonë dhe do të shihni elemente të qarta se si propozohet një buxhet dhe si realizohet ai si i tillë, i shihni në faqe zyrtare oraret e dëgjimeve publike, numrin e pjesëmarrësve nëpër ato takime dhe po ashtu do të shihni propozimet dhe miratimet e kërkesave të qytetarëve, por edhe ato të pamiratuara sepse nuk do të thotë që të gjitha duhet të miratohen, si dhe gjithë propozim projektbuxhetin me të gjitha elementet dhe detajet e nevojshme që do të duhej t'i ketë një buxhet i tillë. Unë për kureshtjen e juaj po e potencoj një organizatë të një punëtori që punon brenda Komunës e që emrin nuk do t'ia përmend sepse e di që i hakmerren, por po ju tregoj, si vijon, qytetari 1(një) i moshës 27 vjeçare me vendbanim në Podujevë thotë se nuk ka qenë në dijeni se duhet të marrë pjesë në dëgjimin publik për buxhet, mandej qytetari tjetër i moshës 33 vjeçare thotë se nuk marrë pjesë pasi që mendoj se ato janë të organizuara vetës si formalitet e që po del se edhe janë, pastaj qytetari tjetër thotë planifikim i papërshtatshëm gjatë orarit të punës dhe nuk kam kohë për të marrë pjesë në takime të tilla dhe ka rekomanduar që ato të mbahen pas orarit të punës ose në fundjavë, ndërsa ajo çka është më rëndësishmja të gjithë ata që kanë marrë pjesë kanë treguar që asnjërit prej tyre nuk ju është ofruar ndonjë kopje fizike e dokumentit me projektet që duhet t'i ketë buxheti i tillë.

Element tjetër që është shumë i rëndësishëm për buxhetin është ekzekutimi i këtij buxheti, kurse si po ekzekutohen buxhetet jemi dëshmitarë të gjithë ne këtu si asamblistë por edhe si qytetarë, këta thjesht janë të interesuar t'jua miratojmë buxhetin dhe të na bëjnë hisedar në keq menaxhimin e këtij buxheti, e po get që disa prej tyre i paskan dërguar edhe në fantazi të skajshme që edhe mund të jenë shumë të kënaqur edhe me buxhetet për të cilat mund të jenë edhe dëshmitar se si janë realizuar, ndërsa se si janë realizuar buxhetet dhe si do të realizohet edhe ky, ngase sigurisht që me votat e koalicioneve të fshehta ju do ta kaloni këtë, por e ka dëshmuar më së miri raporti i auditorit sipas të cilit buxheti për paga dhe mëditje ishte rritur nga të hyrat vetanake në vlerë prej 81,621.00€ për ta mbuluar një deficit buxhetor për arsimin e mesëm dhe shëndetësinë, kurse paramendojeni te kategoria mallra dhe shërbime kanë pasë rënie, për të vazhduar me rritjen e buxhetit për subvencione dhe transfere pasi që ishte edhe vit zgjedhor, ndërsa sipas nenit 18 pika 3 e Rregullores së Ministrisë së Financave për shpenzimet e parasë publike, shpenzimet duhet t'i kenë kodet adekuate të përcaktuara me Udhëzim Administrativ për planin kontabël, e natyrisht që mos zbatimi i kësaj Rregulloreje krijon hapësira për keq klasifikim të shpenzimeve e madje edhe për keq menaxhim të buxhetit. Mandej ky buxhet i cili po kërkohet të votohet sot këtu nga Ekzekutivi i Komunës në krye me një Nënkryetar që dirigjohet në ditët e vikendit, po eliminon operator ekonomik me oferta më të lira dhe po i favorizon operatorët ekonomik me oferta më të shtrenjta, gjëra që do t'i shohim në raportin financiar që do të vie. Element tjetër me rëndësi n'kuadër të buxhetit që do të na bënte neve

të ndihemi krenar ndoshta edhe për ta votuar, do të ishte mirë që edhe raportet financiare të silleshin të qarta dhe të shohim se si po shpenzohet ky buxhet, kurse ne jemi dëshmitar se sillet ai dhe si shihet qartë se tenderët dhe kontratat lidhen kryesisht nëpër kafe/restorante, ndërsa mbulohen me letra nëpër Komunë, për fat të keq.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, theksoi, ka qenë paksa si praktikë, mirëpo Kryesuesi i Kuvendit po na anashkalon që fillimisht drejtorët e Drejtorive të paraqesin të paktën disa fjalë hyrëse rreth projektbuxhetit edhe pse i keni në materialet e dërguara, por të paktën orientimet në mënyrë që të mos merr kahje që të merren vetëm kritikë dhe lëvdatat dhe në fund të sqarojmë ne diçka por megjithatë e ka praktikuar kështu dhe po vazhdon dhe jemi këtu ku jemi.

Për këtë projektbuxhet është punuar dhe është miratuar në muajin qershor me miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore-KAB si dokument që i paraprinë buxhetit e që në DSHPMSH nuk ndonjë ndryshim të madh nga KAB përveç trotuareve që janë shtuar përkatësisht kanë hyrë rr.”Blerim Bajrami” dhe disa rrugë në fshatin Shtedim dhe ndriçimi publik në fshatin Orllan, pra nuk ka pas ndonjë kërkesë qoftë nga këshilltarët, qoftë nga komuniteti qoftë nga debatet publike sepse në një mënyrë buxhetet janë vijimësi e punëve e që ne jemi këtu që sa vite dhe sigurisht jemi në dijeni të gjithë duke përfshirë edhe juve si këshilltarë për punët që janë kryer dhe ato që kanë mbete pa u kryer dhe ato që do të përfundojnë.

U përmend disa herë që projektet po grumbullohen dhe nuk ka detajim të secilit projekt veç e veç por instruksionet e Ministrisë së Financave që projektet e natyrës së njëjtë sa më shumë të jenë të koduara në kuadër të një kodi por megjithatë ne i kemi ndarë sepse ka qenë edhe kërkesë e tyre ti ndajmë, ta zëmë ndriçimi publik ka vetëm një kod dhe tani i kemi 42 fshatra që përfshihen në këtë projekt e që po të futeshin në një kod pastaj do të thuheshin gjëra të ndryshme (vit zgjedhor e gjëra të ngjashme), pra megjithatë janë detajuar me fshatra dhe kryesisht do të jenë rrugët kryesore në fshatrat përkatëse e që besoj se në rrugët kryesore nuk qarkullojnë qytetarë që janë mbështetës vetëm të një partie por shfrytëzohen nga të gjithë.

Sa i përket strukturës së buxhetit, janë partitë politike në pushtet ato të cilat bëjnë planifikimet dhe orientojnë politikat kurse sa është i mirë apo jo i mirë pastaj e vlerësojnë të tjerët dhe qytetarët përmes votës dhe përmes punës, pra dua të them se ne si pushte mund të japim vlerësime shumë të mira për këtë projektbuxhet, kurse opozita mund të thotë atë që edhe po e thotë sikurse që u fole gjatë kësaj pike, madje këshilltarja znj.Lirika Maliqi e tha se ne paraqesim një strukturë tjetër të buxhetit e që të cilën unë jam shumë i bindur që po edhe nëse ishin në pushtet nuk do të mund ta bënin sepse nuk e lejon struktura e Ministrisë së Financave sepse është e pamundur ta orientosh një orientim të tillë të buxhetit në kategori të ndryshme ashtu siç u cek e që ndoshta edhe ne ndoshta kemi dëshirë të planifikojmë orientime të tilla por kemi limitet dhe kufizimet përkatëse buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave sa i përket kategorive dhe programeve të ndryshme buxhetore, megjithatë struktura e buxhetit të DSHPMSH ka ndryshuar, që dy vite janë duke u zvogëluar investimet kapitale (në vitin 2018 kemi pasë mbi 2 milion euro kurse tani kemi vetëm rreth 700,000.00€) për shkak se një pjesë e strukturës së buxhetit vazhdimisht po bartet në bujqësi, shëndetësi dhe kategori tjera.

Struktura buxhetore e DSHPMSH prej 1,700,000.00€ është e tillë, sepse çdo herë po flitet (vetëm asfalt, vetëm kanalizim etj të ngjashme), pastaj dëgjova dikë prej këshilltarëve parafolës i cili e potencoj që pse në shekullin XXI me zhavorr, e që për mendimin tim në njërën anë të thuhet përse po asfaltoni rrugë dhe në anën tjetër pse po rregulloni rrugë me zhavorr konsideroj se është paksa kontradiktore kjo, dhe ta keni parasysh se jemi Komunë e madhe me territor 633 km² dhe mund ta

merrini me mend sa rrugët janë në për fshatra e që të gjitha nuk janë të asfaltuara, prandaj edhe orientohet një pjesë e madhe e buxhetit edhe në asfalt.

Për ndriçim publik janë planifikuar rreth 420,000.00€ apo 24.7% të buxhetit të DSHPMSh, do të thotë që struktura më e madhe e buxhetit të Drejtorisë në fjalë ka kaluar në këtë fushë sepse nevojat dhe kërkesat janë shumë të mëdha dhe që siguria e qytetarëve është shumë më e madhe pastaj, mandej për trotuare kemi ndarë rreth 15.9% e buxhetit të DSHPMSh, për kolektorë dhe kanalizime kemi ndarë rreth 179,000.00€ apo 10.5% të buxhetit të Drejtorisë, pastaj kemi edhe planifikime buxhetor në shumë rreth 174,000.00€ apo 10.3% për zgjerim dhe trajtim të lumenjve me mure mbrojtëse, për ujësjellës ku përfshihet edhe hyrja e qytetit janë rreth 160,000.00€ apo 9.4%, ura dhe të tjera janë rreth 134,000.00€ apo 7.9%, kurse të gjitha të tjerat rreth 21% e buxhetit të Drejtorisë janë shpenzime tjera si meremetim i rrugëve me zhavorr, varrezave, riparim i asfaltimeve dhe hapësirat publike, prandaj kjo është struktura të cilën e kemi si buxhet brenda për brenda Drejtorisë, dhe këto janë fakte.

Ky projektbuxhet ka kaluar edhe fazat e debateve/dëgjimeve buxhetore publike, madje unë kam marrë pjesë të paktën në tri të tilla ku kanë qenë edhe kolegë tjerë, prandaj edhe e kemi propozuar këtë projektbuxhet me bindjen e plotë që do të realizohet, është ndikues tek të gjithë dhe gjithëpërfshirës, i mirëpritur dhe i realizueshëm, ndërsa alternativat tjera janë ashtu siç edhe i keni dhe mbeten vetëm politike.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit rreth asaj që u cek për dhënien e fjalës, theksoi, unë fillimisht e ftova drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave që të paraqesë fjalën hyrëse në emër të Ekzekutivit të Komunës, dhe e pash të arsyeshme që gjatë debateve të këshilltarëve të Kuvendit të merrni pyetjet, vërejtjet dhe shqetësimet e tyre që pastaj të keni mundësi edhe të përgjigjeni.

z.Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, theksoi, nga këshilltarët parafolës u parashtruan dy-tri pyetje për të cilat dëshiroj të jap përgjigje dhe sqarime të nevojshme, sa i përket rrugës Bellopoj-Dyz të cilën e ceku këshilltari z.Rafet Llapashtica, është shumë e vërtetë se ajo rrugë është me dëmtime të mëdha e cila është shkatërruar gjatë ndërtimit të Burgut të sigurisë së lartë dhe për të cilën unë personalisht dy herë ka shpreh shqetësime përmes mjeteve të informimit, por të cilën Ministria e Drejtësisë e ka marrë përsipër për ta rregulluar sepse gjatë ndërtimit të Burgut të cekur ka pasë kamion me pesha shumë të rënda dhe është dëmtuar ajo rrugë dhe tani mund t'ju informoj se të hënën (para dy ditëve) kemi dal bashkërisht me një komision të Ministrisë së Infrastrukturës dhe me projektuesit e kësaj Ministrie të cilët e kanë të drejtën e hartimit të projektit dhe shpresoj që brenda javës së ardhshme projekti do të jetë i gatshëm që Ministria ta rregullon atë rrugë e cila fillon nga rruga regjionale Lluzhan-Orllan deri në pjesën e epërme të fshatit Bellopojë, pra shpresoj që do të rregullohet në bazë të asaj që është thënë në takimet që kemi pasë.

U përmend Plani Zhvillimor Komunal e që thuhet disa herë që nuk ka plan të tillë, mirëpo ju jeni dëshmitar që është votuar në këtë Kuvend andaj nuk e kuptoj përse thuhet që nuk ka Plan Zhvillimor Komunal, nëse ndokush nuk e din çka është ky plan, ne mund tua sjellim nga një kopje por edhe mund ta gjeni në faqe zyrtare të Komunës.

Sa i përket Zonës Industriale, mund t'ju them se ne në dokumentin e draft Hartës Zonale e cila shpresojmë se do të përfundoj në muajin tetor të këtij viti dhe do ta marrim edhe pëlqimin nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, është e përcaktuar dhe pavarësisht se ajo pronë a është private apo shtetërore, Komuna ka të drejtë që atë që e ka planifikuar dhe që këshilltarët e Kuvendit e kanë votuar do të kemi mundësi të bëjmë shpronësim, mirëpo ne jemi në dijeni se kemi një pronë Komonale që në të kaluarën ka qenë Ndërmarrja Shoqërore – Kooperativa Bujqësore e që ne kemi

pas disa takime me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe në momentin që Harta Zonale të kaloj atëherë do të kemi takimet përfundimtare për Zonën Industriale, pjesë e cila është pronë Komunale e juaja dhe e jona.

Çështje tjetër që u përmend është edhe asfaltimi e për të cilën nuk kam çfarë t'ju sqaroj, pjesa më e madhe e juaja e keni asfaltin deri në shtëpitë e juaja mirëpo duhet pasë parasysh se kanë mbete edhe pjesë tjera pa asfalt e që duhet t'ju shtrohet në mënyrë që të jemi të barabartë para qytetarëve dhe do të vazhdojmë të punojmë në atë drejtim, këtë vit kemi 38 fshatra në të cilat jemi duke asfaltuar rrugë dhe për vitin ardhshëm po ashtu kemi një numër të madh të rrugëve e që besojmë se afërsisht do të përmbyllen asfaltimet për shkak se kemi një numër të madh të rrugëve rurale të paasfaltuara siç janë në pjesën e Orllanit e që pjesa më e madhe juaja nuk kaloni në ato pjesë, pastaj në pjesën e Kushevicës që kemi planifikuar për dy vite të rregullohet ajo rrugë prej 2.5 km gjatësi e cila lidhet me pjesën e Prishtinës përkatësisht me fshatin Nishefc e që edhe Komuna e Prishtinës është duke punuar për t'i bashkuar këto dy rrugë, por që për shkak të mungesës së mjeteve të mjaftueshme financiare nuk kemi mund ta përfundojmë deri në fund atë rrugë, mandej kemi rrugën e fshatit Metergoc për të cilën jeni në dijeni se ajo rrugë mund të lidh pjesën e Kosovës me pjesën e Medvegjës, është rrugë me gjatësi rreth 4 km e cila duhet të ndërtohet, lokalitet në të cilin ashtu siç e kemi diskutuar disa herë janë rreth 7 ferma të mëdha të lopëve prandaj ne si Komunë duhet dhe do t'iu ndihmojmë atyre banorëve dhe fermerëve.

Sigurisht që nuk keni vizituar edhe fshatra tjera që kanë rrugë në gjendje jo të mirë dhe pa asfalt, unë kam vizituar dhe kam vlerësuar që duhet të asfaltohen disa prej rrugëve sipas mundësive buxhetore që kemi sikurse që janë fshatrat Bllatë, Rakinicë, Brainë e të tjera, fshatra të cilat rrugët i kanë në gjatësi të madhe por që ndoshta nuk kanë numër të madhe të banorëve, mirëpo një pjesë e tyre kanë shprehur dëshirë të kthehen dhe të investojnë në biznese të ndryshme në atë pjesë e që shpresojmë që me buxhetin që do ta kemi të ardhmen do të arrijmë t'i asfaltojmë edhe ato rrugë.

Me buxhetin e planifikuar dhe lejuar për vitin 2021 për investime kapitale kemi rreth 3,341,000.00€ e që shpresojmë që do t'i sjellim të mira qytetarëve të Komunës së Podujevës që bashkërisht të vazhdojmë të ecim përpara, prandaj edhe ju ftoj ta votoni.

z.Zaim Thaqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS, theksoi, dëshiroj të përgjigjem dhe të jap sqarime ekskluzivisht në dy pyetjet apo shqetësimet e ngritura nga disa këshilltarë parafolës, ku është fjala te shuma e planifikuar sipas jush 100,000.00€ për patronazhin, edhe pse ne si planifikues të buxhetit për shëndetësi mendojmë se do të ishte ide e mirë mirëpo patronazhi është një shërbim i cili është shuar me Ligjin për shëndetësi, do të thotë ka ekzistuar një shërbim i tillë para luftës por që është shuar me Ligjin për shëndetësi, dhe të gjitha shërbimet që janë kryer përmes patronazhit kalojnë në mjekësi familjare, pra çdo institucion publik shëndetësor duke filluar prej ambulantave, qendrave të mjekësisë familjare, qendrave kryesore të mjekësisë familjare e kryejnë shërbimin e patronazhit, mirëpo si patronazh është shuar andaj aktivitetet e dikurshme të patronazhit janë shuar me Ligjin për shëndetësi dhe si të tilla janë të ndaluara por që ato aktivitete apo shërbime vetëm vazhdojnë të kryhen prej mjekësve dhe profesionistëve shëndetësorë.

Sa i përket shqetësimit tjetër të ngritur rreth shumës buxhetore të ndarë për blerjen e pajisjeve mjekësore për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF, si duket ekziston një mosmarrëveshje apo keqkuptim të cilin e keni ju disa prej këshilltarëve sepse në QKMF hyjnë edhe Ambulantat e Mjekësisë Familjare-AMF dhe Qendrat e Mjekësie Familjare-QMF të cilat ngërthehen në QKMF andaj çdo investim që llogaritet të jetë në QKMF i përfshinë edhe AMF-të dhe QMF-të, ndërsa sa për informatën e juaj në këtë vit që jemi 2020 përfundon projekti i ndërtimit të objektit të ri të Emergjencës i cili ka qenë projekt dy vjeçar 2019/2020 me një investim të përbashkët mes

Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Shëndetësisë, por që në vitin e ardhshëm mendohet dhe planifikohet që me këtë shumë buxhetore të ndarë ai objekt të pajiset me aparaturë mjekësore.

znj. Donika Sfishta, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, theksoi, sa i përket pyetjes rreth Bibliotekës së Qytetit, çështje për të cilën z.Rafet Llapashtica ka parashtruar pyetje dëshiroj të jap një sqarim, tash për tash Biblioteka aktuale e qytetit është funksionale në ish objektin e Komunës, ndërsa në vitin 2021 është paraparë në objektin e ish “Bëni Dona” i cili do të rinovohet.

z. Vezir Januzi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, theksoi, unë kam vetëm lajme të mira rreth bujqësisë, kurse për buxhetin besoj se të gjithë jemi kontribut dhënës ngase kemi të bëjmë me një dokument strategjik qoftë për ekzekutivin e Komunës qoftë për asamblistët dhe qytetarët në përgjegjësi sepse taksat e tyre po kthehen në investime të ndryshe siç janë ato kapitale, subvencione e të tjera.

Gjatës seancës së jashtëzakonshme që është mbajtur rreth dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ashtu siç edhe jeni në dijeni në fund janë mbështetur dy propozimet e DBPZHR ku për njërin dëshiroj t’ju njoftoj qysh sot se në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që kemi pasë tani veç janë duke implelementuar respektivisht duke u realizuar kompensimet e dëmeve për 6 majorin e parë ku kjo ministri ka lejuar 295,000.00€ nga e cila 25% e dëmeve të vlerësuara do t’iu kompensohet fermerëve. Besoj që shumë shpejt do të implelementohet edhe pjesa e dytë dhe edhe fermerët të cilët kanë pësuar dëme në gjashtëmujorin por edhe në kohën e fillimit të pandemisë do të kompensohen.

Sa i përket propozimit tjetër të Drejtorisë së është përkrahur në këtë Kuvend ka të bëjë me premtimin tonë që në buxhetin e vitit 2021 të futet një kod për dëmet në bujqësi ne e kemi mbajtur premtimin dhe kemi ndarë një shumë të mjeteve prej 76,350.00€ e që është një situatë e re sepse për herë të parë Komuna e Podujevës ndan buxhet për kompensimin e dëmeve eventuale nga kushtet klimatike apo dëmet tjera që mund të paraqiten tek fermerët apo bujqit tanë.

Çështje tjetër është edhe investimet në ambient që në kuadër të investimeve për vitin 2021 kemi menduar (por edhe në takimet / dëgjimet buxhetore me qytetarë që kemi pasë e që nuk është e vërtetë ajo që u tha se nuk ka pas, sepse ka pasë) dhe kemi ndarë buxhetin prej 100,000.00€ e që sigurisht që jeni në dijeni se lumi Llap po pastrohet, zgjerohet dhe rregullohet për çdo vit e më shumë, pasta po mbillen drunj dekorativ, po rregullohen hyrjet daljet qytetet dhe shumë e shumë investime tjera që do të ndodhin në vitin 2021 e që vërtetë qytetit do t’i jepet një pamje e bukur por edhe pjesëve tjera përreth. Jam shumë i lumtur që ky projekt është para juve me kontributin e të gjithëve qoftë si Ekzekutiv qoftë si Kuvend dhe natyrisht pres që të miratohet së bashku me projekt buxhetin e Komunës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2022/2023.

znj. Doruntina Hasani, theksoi, lidhur me përgjigjen e drejtoreshës së DKRS e cila e potencoj se janë planifikuar 50,000.00€ për renovimin e ish “Beni Dona” e cila do të shndërrohet në Bibliotekë të qytetit, çështje për të cilën mendoj se është shumë absurde sepse ne të gjithë e dim se sa mund të rregullohet ai objekt me 50,000.00€, madje një shtëpi në gjendje normale nuk mund ta rregullosh me këtë shumë e lëre më për atë objekt i cili as nuk ka dritare e as gjëra tjera elementare kështu që konsideroj se është shumë qesharake dhe vetëm sa për të na “hedh hi syve”.

z. Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, konsideroj se debati rreth shqyrtimit të këtij propozim vendimi përfundoj, andaj të njëjtin e hedh në votim, përfshirë edhe kërkesën e drejtorit të DBF-së që e paraqiti në fjalën hyrëse për ri rregullimin e nenit 1 të këtij propozim vendimi.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 19 vota për, 9 vota kundër dhe 5 vota të përmbajtura miratohet propozim vendimi për projektbuxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore 2022-2023, sipas materialit përkatës dhe kërkesës së drejtorit të DBF për ri rregullimin e nenit 1, dhe atë;

Te burimet e financimit, përkatësisht paragrafit 1 i shtohet edhe një nënparagraf, dhe atë; klauzola e investimeve kalon si e veçantë në nënparagrafin 1.2, kurse të hyrat vetanake kalojnë në nënparagrafin 1.3 të këtij neni, kurse shumat buxhetore mbeten të njëjta.

2. Propozimi Vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë-38

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, bazuar në Ligjin nr.07/L-014 për ndryshime dhe plotësimin e Ligjit me nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, neni 5 paragrafi 6, rezerva Komunale trajtohet, si vijon, *rezerva në buxhetin e Komunës me vendim të Ministrit mund të bartet në kategoritë e pagave dhe shtesave dhe në varësi nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.06/L-111 për Pagat në sektorin publik, në rast të situatës kur kjo nuk është e nevojshme, rezerva e tillë buxhetore me aprovim të ministrit mund të bartet në të gjitha kategoritë e shpenzimeve me përjashtim të kategorisë së pagave dhe shtesave sipas kërkesës dhe vendimit të Kuvendit të Komunës*, lëvizje buxhetore të cilat nuk janë subjekt i kufizimeve të transfereve dhe të përfshira në nenin 30 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, apo të nenit 15 të Ligjit bazik të buxhetit të vitit 2020.

Të nderuar, mjetet e parapara për implementimin e Ligjit për paga të ruajtura si rezervë në kategorinë ekonomike-38 fillimisht kanë qenë 1,690,511.00€, shumë nga e cila 154,800.00€ janë shpenzuar nga Qeveria e Kosovës për pagat shtese për punëtorët e shëndetësisë, njësisë së zjarrfikësve dhe inspektorëve komunal, që ka qenë dy herë me nga 300.00€ për dy muajt e parë si kompensime shtesë për këto kategori, kurse shumat tjetër prej 1,528,916.00€ kanë mbetur për tu shpërndarë sipas nevojave të Komunës në programe dhe projekte të vitit 2020 por duke ruajtur grandin specifik të arsimit dhe shëndetësisë, mjete këto të cilat mund të shpenzohen vetëm në programin e arsimit dhe shëndetësisë.

Për fund mund t'ju them se shpërndarja e këtyre mjeteve buxhetore është bërë sipas specifikacionit të bashkëngjitur propozim vendimit përkatës, ndërsa në rast se kërkohen sqarime shtesë, prezent këtu janë edhe Drejtorët e Drejtorive tjera të cilët mund ta marrin fjalën.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së e ka analizuar këtë propozim vendim dhe si të tillë e përkrahim transferimin e buxhetet nga kategoria e rezervave në kategoritë tjera përkatëse.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, lidhur me këtë pikë, siç e ceku edhe drejtori parafolës i DBF ka të bëjë me ridestinimin e shumës rreth 1 milion e gjysmë euro nga kategoria e rezervës komunale si pasojë e mos hyrjes në fuqi të Ligjit për paga sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, si rrjedhojë kjo do të ishte një mundësi shumë e mirë për Komunën në përgjithësi por edhe qytetarët në këtë kohë po të shkonin në vendin e duhur, por prap se prap Komuna e Podujevës po vazhdon të mbetet shumë misterioze ndaj qytetarëve dhe ndaj neve këshilltarëve si përfaqësues të deleguar të tyre, unë nuk e di se si ndiheni ju si asamblist (pozitë/opozitë) nëse nuk dini një t'ia sqaroni ndonjë qytetari se ku do të shkojnë këto para, atëherë për çka jem përfaqësues të tyre ne, apo ndoshta më mirë të mos jemi fare këtu fare me këtë gjendje si jemi, shembull në dokument thuhet: *transferohen mjetet buxhetore nga kategoria rezerve në kategoritë buxhetore*

si vijon: nga arsimi i mesëm, nga arsimi fillorë, nga arsimi para fillorë dhe çerdhet, shuma totale 659,932.00€ transferohen në kategorinë mallra e shërbime, në nën programin arsimi fillorë, e që konsideroj se ish dashtë ta cekni i nderuar drejtor dhe të mos na kurseni sepse edhe ne lexojmë prandaj edhe ish dashtë ta shkruani më gjatë e jo vetëm 4 faqe por të jepni më shumë sqarime, ose nëse përton ti, mund t'i thoni secilit drejtor të Drejtorisë përkatëse të na dërgohen informacione se ku do të shpenzohen, pra po e përsërisë, përse po na kursen në këtë drejtim sepse ne e kemi për detyrë këtë dhe ndoshta janë të nevojshme të transferohen ndokund tjetër këto mjete. Pra këto janë transferime në kategorinë e shpenzimeve komunale, nën programin e arsimit fillorë shuma 15,000.00€, mirëpo ditët po kalojnë dhe investimet kapitale pak përmenden dhe nuk kemi informacione të mjaftueshme, shembull, thuhet; *planifikimi hapësinorë dhe rregullativ, shpronësimi i pronës në rrugën tek Xhamia, infrastruktura publike, ndërtimi dhe rindërtimi, ndriçimi publik*, mirëpo keni mundur të specifikoni se ku do të reazlihen këto projekte në mënyrë që dhe ne si këshilltarë të Kuvendit të jemi në dijeni dhe të kemi informata t'jua sqarojmë edhe qytetarëve pastaj se ku po transferohen këto mjete.

E kemi parasysh që është shumë e nevojshme që të transferohen mjete buxhetore në arsim, mirëpo të dimë se ku, shembull, do të ishte mirë që të blihen maska shumë përdorimshme në këtë kohë në mënyrë që t'ju gjindemi qytetarëve pranë e që do të ishte mirë edhe për ju, prandaj në këtë formë ne nuk po dimë se çfarë po votojmë mirëpo po shpresoj që në vazhdim do të marrin fjalën edhe drejtorë të drejtorive tjera dhe do të japin sqarime më të detajuara.

z.Fatmir Rudari, theksoi, ne Grup i këshilltareve nga radhët e PDK-së nuk mund të dalim kundër transferimit të këtyre mjeteve për arsye se një kohë të gjatë kemi kërkuar që të ketë investime më shumë në arsim e që shihet se një pjesë e madhe e këtyre mjeteve transferohen në arsim, mirëpo meqë drejtori i Drejtorisë së Arsimit është prezent këtu, ndoshta do të na specifikon pak më në detaje se ku janë të planifikuara të shpenzohen këto mjete në mënyrë që ne si Grup ta votojmë këtë propozim vendim pasi që është edhe obligim ligjor një gjë e tillë.

z.Vezir Januzi, drejtor i DBPZHR, theksoi, e ceka edhe më herët se për fushën e bujqësisë ka vetëm lajme të mira, Komuna e Podujevës nga ky buxhet rezervë jemi kujdesur për bujqësinë dhe kemi ndarë një shumë prej 180,000.00€ kur jemi në dijeni që dëmet në bujqësi kanë arritur shumën deri 700,000.00€, dhe duke parë që Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i stimulon/kompenson këta fermer për dëmet e shkaktuara me një shumë prej 25% të vlerësimit të dëmit përkatës, por edhe ne si Komunë kemi menduar që me një përqindje t'i përkrahim fermerët e dëmtuar, e që secili prej juve mund t'i shikoni edhe raportet e dëmeve për secilin fermer veç e veç e që nuk do ta lemë anash edhe sektorin/fushën e Bletarëve të Komunës së Podujevës sepse kushtet klimatike në këtë vit e kanë bërë të pamundur për fermerët bletarë që ata të kenë mundësinë këtë vit të vjelin mjaltin e që pothuajse të gjithë kanë bërë investime jashtëzakonisht të mëdha në shoqëri të bletëve apo edhe në infrastrukturën e tyre dhe mendoj që një pjesë e këtyre mjeteve do të shkojë për fermerët bletarë.

Një shumë prej 30,000.00€ e kemi ndare për projektin e radhës që do të implementohet këtë vit, që është për fermerët në fushën e pemëtarisë dhe perimekulturës ku do të përfshihen 100 fermer me multikultivator dhe pajisje përcjellëse. Gjithashtu një lajm tjetër që sigurisht e keni dëgjuar të gjithë që Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës tani më ka marrë vendim dhe ka ndarë buxhet për të gjithë fermerët në nivel vendi që t'i dyfishoj pagesat direkte, e që Komuna e Podujevës ka një numër shumë të madh të fermerëve e që janë mbi 2000 fermer aplikues për pagesat direkte në fusha të ndryshme.

z.Agim Blakqori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, theksoi, duke falënderuar drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i cili e sqaroi se si kemi ardhur deri te kjo situatë rreth çështjes së këtyre mjeteve buxhetore rezerve, meqë pjesa më e madhe e këtyre mjeteve ka të bëjë me Drejtorinë e Arsimit, atëherë e shohë të nevojshme që të jap disa sqarime se si i kemi planifikuar t'i orientojmë këto mjete dhe në të njëjtën kohë kërkoj nga të gjithë ju ta përkrahni këtë propozim vendim sepse është një mundësi e mirë edhe përkundër faktit që kemi një kohë shumë të shkurtër për t'i realizuar këto planifikime por megjithatë na nevojitet vota juaj sot në mënyrë që ne të procedojmë menjëherë që nga sot për t'i realizuar këto projekte.

Janë të ndara 168,800.00 € për subvencione të cilat i kemi planifikuar t'i subvencionojmë të gjithë nxënësit dhe studentët të cilët kanë aplikuar për bursa, gjithashtu e kemi planifikuar edhe 260,000.00€ për investime kapitale ku 130,000.00€ shkojnë për vazhdimin e punimeve në shkollën e fshatit Balloc e cila veç se ka filluar dhe do të jetë një ndihmesë e mirë kjo në mënyrë që të punohet sa më shumë në këtë vit, pastaj 30,000.00€ shkojnë për fusha sportive (kemi 3 fusha sportive të cilat veç se i kemi në procedurë), planifikojmë që me këto mjete të ndara t'i rrumbullakojmë e që njëra prej tyre është në fshatin Pakashticë, mandej një në fshatin Llapashticë e Poshtme.

Për informacione rreth këtyre projekteve të planifikuara që do të realizohen ekzistojnë sepse janë projekte të planifikuara por vetëm na nevojitet edhe mbështetja e Këshilltarëve të Kuvendit sot këtu në mënyrë që të procedojmë tutje. Pastaj kemi edhe 100,000.00€ të planifikuara për përmirësimin e infrastrukturës, pjesa tjetër prej 659,932.00€ është e planifikuar për mallra e që n'kuadër të tyre kemi planifikuar t'i furnizojmë dhe t'i pajisim shkollat me laboratorë për shkencat natyrore, t'i furnizojmë shkollat me pajisje për teknologji, mandej pajisja me rekuizita dhe mjete për zhvillimin e orës së edukatës fizike si dhe furnizim i shkollave apo bibliotekave të tyre me libra e që janë planifikuar 659,932.00€. prandaj mundësitë janë por vetëm kërkohet vota juaj sot që të kaloj ky propozim vendim.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, theksoi, sa i përket DSHPMSh nga ky fond buxhetor rezerve kemi një shumë prej 650,863.00€ e cila është planifikuar përkatësisht propozuar të transferohet, shumë e cila është vogël dhe mendoj se janë të nevojshme edhe shumë më shumë mjete buxhetore për projekte të ndryshme brenda DSHPMSh, mirëpo meqë kërkesa ka qenë që buxheti nga ky fond rezervë të destinohet brenda Drejtorive më të mëdha andaj edhe pjesa më e madhe nga ky fond është planifikuar në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorinë e Arsimit.

Sa i përket ndriçimit publik se ku do të bëhet, meqenëse në qytet KEDS-i është duke bërë ndërrimin e shtyllave të vjetra të drurit dhe vendosjen e rrjetit të ri tokësorë atëherë edhe shtyllat po hiqen të gjitha, atëherë edhe ndriçimi duhet të përcjellët në vazhdimësi me shtylla metalike, disa rrugë i kemi përfunduar, disa jemi në proces siç janë: rr."Afrim Zhitia", rr."Ilir Konushëfci", rr."Bahri Fazliu", rr."Nazmi Gafurri" e të tjera, rrugë këto që kryesisht këtë vit, me këtë buxhet shtesë do të pajisen me shtylla metalike dhe nga to do të largohen ato shtylla që janë me material druri dhe betoni. Gjithashtu me këtë buxhet shtesë një pjesë e investimeve do të destinohet për 6 rrugë të fshatit Letancë ("Ismail Qemaili", "Vëllezërit Blakqori", "Sami Plakolli") dhe disa rrugë të cilat kanë mbetur dhe janë në fazën e disa asfaltimeve e që me këto investime e përfundojmë tërësisht fshatin Letancë, dhe po ashtu në këto investime janë të përfshira edhe dy rrugë kryesore që lidhen me fshatin Dumnicë, nga dalja e qytetit deri tek ajo që ne e quajmë rruga e "Liqanve", në atë pjesë ku nuk ka shtylla të KEDS-it dhe duhet t'i vendosim shtyllat metalike.

Po ashtu edhe rr.“Selim Obrança”, nga pjesa në afërsi të Restorant Artela deri tek hyrja e fshatit Llapashticë, rrugë e cila siç jeni në dijeni është shumë e frekuentuar si nga qytetarët ashtu edhe nga vetë banorët e asaj ane andaj edhe ka nevojë për ndriçim.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, sa i përket deklarimeve të Drejtorit parafolës z.Faik Muçiqi ishte më se sqaruese, mirëpo konsideroj se ish dashur që këto deklarime të sillen në mënyrë të shkruar, ndërsa sa i përket Drejtorit të Arsimit, njëjtë sikurse informatat po ashtu edhe sqarimi ishte i njëjtë nuk shtoi diçka specifike, e që neve na duhen informata se në cilin vend saktësisht do të bëhen investimet përkatëse, mirëpo kërkoj që herëve tjera më shumë kujdes kur diçka sillet në Kuvend të sqarohet mirë gjithçka.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 26 vota për, asnjë votë kundër dhe 7 vota të përmbajtura, miratohet propozim vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë – 38.

3. Të Ndryshme

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në Grupin e këshilltarëve nga radhët e PDK-së kanë ardhur një numër i madh i ankesave të qytetarëve që të ngritët një komision për trajtimin e ankesave rreth emërimit të rrugëve, jemi në dijeni se ka qenë i ngritur një komision për emërimin e rrugëve i cili ka përfunduar punën e vetë e që në bazë të të dhënave që kemi nuk është krejt ashtu siç janë votuar në raport me ato që janë paraqitur nga ana e qytetarëve, por ka edhe disa vende që është bërë ndryshimi i emërimit të rrugëve me atë që është miratuar në Kuvend. Në fakt ne i kemi miratuar në mënyrë unanime të gjitha emërimet e sjella nga tubimet dhe debatet e mbajtura me qytetarë të zonave të ndryshme, kështu që nëse është bërë një gjë e tillë është shumë keq, madje nëse Drejtoria përkatëse ka bërë ndryshme të emërtimeve me atë çfarë është miratuar në Kuvend është gjë e jo e mirë dhe merr një kahje tjetër pastaj, kështu që të paktën të kemi një përgjigje nga Drejtoria përkatëse që një komision i tillë nuk do të ngritët, ose të ngritim një komision në mënyrë që të trajtohen ato ankesa që janë në numër shumë të madh, të cilat ai komision do t'i trajtoj dhe të kthej përgjigje, ose fundja të mbeten ashtu siç janë.

Kështu që propozoj që në seancën e radhës të përfshihet në rend të ditës kjo temë dhe të merret një vendim, ose të ngritët ose jo një komision, kjo ngase as ne nuk po dim si të përgjigjemi qytetarëve, pavarësisht që ne mund të kthejmë një përgjigje dhe të themi që nuk jemi në pushtet e gjëra të ngjashme, pra të merremi me këtë çështje e që besoj se një komision i tillë do ta kryente punën e vet dhe pastaj nga kjo çështje do të lirohej qoftë Kuvendi qoftë edhe drejtoria përkatëse.

z.Avni Fetahu, theksoi, fillimisht kam një kërkesë që do të ishte mirë që planin e punës së Kuvendit të cilin e kemi miratuar bashkërisht këtu në këtë Kuvend, të respektohet, sa për rikujtim, për muajin shtator kemi vetëm një pikë që është sjellë nga plani i punës, fjala është për projektbuxhetin, përndryshe ka qenë Informata për përgatitjet për fillimin e vitit shkollor, Rregullorja për tatimin në pronë, dhe Informatë e DBPZHR, pra këto tri pika nuk janë sjellë në këtë Kuvend.

Kam edhe pyetje rreth kolektorit të ujërave të zeza, çështje për të cilën ne si LVV kemi bërë edhe pyetje për qasje në dokumente publike në lidhje me këtë çështje, projekt i cili ka një shumë prej 5 milion e 300 mijë euro dhe projekt me të cilin do të ballafaqohet çdo qeverisje e ardhshme sepse është për vite të tëra që do të paguhet kështu, kurse ne nuk kemi asnjë informatë rreth kësaj çështje. Raporti i auditorit të jashtëm nuk e trajton këtë çështje sepse janë bërë intervenime

politike e që as nuk është publikuar kontrata, as ofertat financiare e asnjë pasqyrë tjetër kurse qytetarët do të paguajnë kredi për vite të tëra për këtë projekt.

z.Hasan Ajeti, theksoi, e mbështesë propozimin e këshilltarit parafolës z.Rafet Llapashtica, gjykoj se është mirë të ngritët një komision i tillë dhe t'i trajtoj të gjitha ankimet e qytetarëve lidhur me emërtimin e rrugëve, temë të cilën e kemi diskutuar edhe me zyrtarë të Ministrisë së Pushtetit Lokal të cilët kanë deklaruar se është në kompetencë të Kuvendeve komunale që të emërojnë apo caktojnë një komision prej 3-5 anëtarëve për çështjen në fjalë.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0059128/20
Podujevë,
30 shtator 2020**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**